

**Republika e Kosovës****Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më **30.04.2012**, pas shqyrtimit të Propozim-vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për përcaktimin e kritereve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për entitetet publike dhe jopublike, dhe duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, mori këtë:

V E N D I M**Neni 1**

Është në diskutim publik Propozim-vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për përcaktimin e kritereve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për entitetet publike dhe jopublike në territorin e Komunës së Vushtrisë.

Neni 2

Diskutimi publik fillon nga data 01.05.2012 dhe zgjatë deri më 23.05.2012.

Neni 3

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna.

Neni 4

Obligohet Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale që si hartues dhe propozues i Propozim-vendimit në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09.

Gjithashtu DSHPS-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Propozim-vendimit në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin Maj 2012.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

Kryesuesi i Kuvendit**Ferit Idrizi**